

Ne fokus/ Chelsea njih Kosovën

nga AlbaniaSoccer

E mërkurë, 04 Dhjetor 2013 22:26



Gjigandi anglez, Chelsea, edhe zyrtarisht ka njohur dhe ka pranuar në gjirin e saj klubin e tifozëve nga Kosova, "Chelsea Fan Club Kosovo". Ky fan club ka njoftuar me anë të një komunikate në rrjetet sociale se është pranuar nga klubi të cilin ata e simpatizojnë. Por, këtë e ka bërë edhe klubi londinez që në faqen zyrtare e ka njohur klubin e tifozëve të Chelseat nga Kosova. Shtohen kështu përjekjet për të përhapur emrin e Kosovës apo dhe tifozëve që ky vend ka për futbollin ndërkombëtar. "Chelsea Fan Club Kosovo" do të ketë mundësi të pajiset me bileta stadiumi ku do të mund të shohi nga afër skuadrën e tyre të zemrës.